



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të Degës së biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softuerik të kamerës të shoqërisë Hella Aglaia Mobile Vision GmbH nga shoqëria Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa Nr. 349 Prot., protokoll i AK-së, datë 29.09.2020, “Përqendrimi ndërmjet Volkswagen AG dhe The Camera Software Business of Hella Aglaia Mobile Vision GmbH”, me të cilën jemi njoftuar se shoqëria Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG synon blerjen e biznesit të sistemit softuerik të kamerës prej shoqërisë Hella Aglaia Mobile Vision GmbH.

Sipas Kontratës së blerjes së degës së biznesit të sistemit softuerik të kamerës, të nënshkruar më datë 28 shtator 2020, palët janë:

Pala blerëse: Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Gjerman. Volkswagen car.SW Org Wolfsburg AG është pjesë e Grupit Volkswagen i cili drejtohet nga ndërmarrja mëmë fundore e grupit Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG). Volkswagen AG operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK

Pala shitëse: Hella Aglaia Mobile Vision GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar më datë 06.04.1998, sipas legjislacionit Gjerman dhe me objekt aktiviteti: zhvillimi dhe shitja e zgjidhjeve dhe komponentëve të sistemit të orientuar drejt aplikimit për përpunimin dixhital të imazhit dhe komunikimin e imazhit.

Hella Aglaia Mobile Vision GmbH do të shesë biznesin e sistemit softuerik të kamerës përfshirë testimin dhe vlerësimin (DAS/TSO).

Garantues i Shitësit: Hella GmbH & Co. KGaA është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Gjerman, i cili ka marë përsipër detyrimet në nenet 14.4.1, 14.5 dhe 16 të “Kontratës së Blerjes”, datë 28 shtator 2020.

Shoqëri Target: Dega e biznesit DAS/TSO - biznesi i sistemit softuerik të kamerës përfshirë testimin dhe vlerësimin. Targeti nuk realizon xhiro dhe nuk ka filiale ose degë në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.